



Në kuadër të Sesionit të 69 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Ministri Bushati kryesoi Këshillin e Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Jug-lindore (SEECP).

Në takim morën pjesë Ministrat e Jashtëm të 13 vendeve anëtare, Komisioneri Fyle, përfaqësues të Presidencës italiane të BE-së dhe të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Në këtë aktivitet u përfaqësua për herë të parë, si pjesëmarrës me të drejta të plota dhe kushte të barabarta, edhe një delegacioni i Republikës së Kosovës*.

Takimi i Nju Jorkut përben një moment të veçantë, pasi ai shënon fillimin e kryesimit shqiptar të SEECP-së, forumit më të lartë të bashkëpunimit për vendet e Evropës Jug-lindore.

Në takim u shpallën prioritetet e Kryesisë shqiptare 2014 – 2015 si vijon, të cilat janë : forcimi i rolit rajonal të SEECP-së, promovimi i dialogut mes vendeve anëtare si një mjet për funksionimin e SEECP-së, si dhe konsolidimi i sektorëve jetikë të SEECP. Gjatë takimit u miratua dhe kalendari i aktiviteteve që do të zhvillohen përgjatë Kryesisë shqiptare.

Kryesia shqiptare e SEECP-së përbën një angazhim të rëndësishëm politiko-diplomatik, në funksion të promovimit të mëtejshëm të rolit e të politikës së vendit tonë në rajon e më gjerë.

Gjatë kryesisë sonë, në Tiranë do të zhvillohen disa takime të nivelit të lartë, ku do të marrin pjesë kryetarë shtetesh/qeverish, kryetarë parlamentesh, ministra të jashtëm dhe ministra të tjerë, sipas prioriteteve të presidencës sonë.

Gjithashtu, janë parashikuar një sërë aktiviteteve rajonale në nivel ekspertësh, përfaqësuesish së shoqërisë civile, botës akademike dhe komunitetit të biznesit.

* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of independence.